



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 2742 Prot.

Tiranë, më 18.05. 2020

UDHËZIM

Nr. 13, datë 18.05.2020

PËR

VLERËSIMIN ME NOTË TË NXËNËSVE QË NUK DO T'U NËNSHTROHEN
PROVIMEVE KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË,
VITI SHKOLLOR 2019-2020, PËR SHKAK TË SITUATËS SË KRIJUAR NGA
PANDEMIA COVID-19

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 26 dhe 50, të ligjit nr. 69/2012 "Për Sistemin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Aktit Normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19",

UDHËZOJ:

1. Provimet Kombëtare të Arsimit Bazë (PKAB), për vitin shkollor 2019-2020, nuk do të zhvillohen, për shkak të situatës së krijuar nga pandemia covid-19.
2. Vlerësimet e nxënësve me notë për këto provime do të bazohen në rezultatet e nxënësit gjatë të gjitha viteve të arsimit të mesëm të ulët.
3. Procedura e vlerësimit të nxënësit me notë në provimet kombëtare të arsimit bazë, të kryhet nga komisionet e vlerësimit të lëndëve të PKAB-së (më poshtë Komisionet e Vlerësimit), të ngritura për çdo lëndë, në institucionet e arsimit parauniversitar, me urdhër të drejtorit të shkollës.
4. Komisioni i Vlerësimit të përbëhet nga 3 (tre) anëtarë:
 - a) drejtori i shkollës;
 - b) nëndrejtori që mbulon lëndën përkatëse;
 - c) mësuesi i lëndës në klasën e nëntë.
5. Nëse në institucionin arsimor nuk ka nëndrejtor, anëtar komisioni zgjidhet një mësues i së njëjtës lëndë, ose një mësues i lëndës së përafërt me lëndën që është provim kombëtar.
6. Për të kryer procedurat e vlerësimit të nxënësve me notë në PKAB, Komisioni i Vlerësimit duhet të plotësojë një evidencë, në të cilën të pasqyrohet:
 - a) Nota përfundimtare e klasës së 6 (gjashtë).
 - b) Nota përfundimtare e klasës së 7 (shtatë).

- c) Nota përfundimtare e klasës së 8 (tetë).
- d) Nota përfundimtare e klasës së 9 (nëntë).
7. Nota e vlerësimit të nxënësit në lëndën përkatëse të PKAB-së të llogaritet me formulën: $NPK = [NP \text{ klasa } 6 + NP \text{ klasa } 7 + NP \text{ klasa } 8 + NP \text{ klasa } 9] : 4$, ku NPK është nota e provimit kombëtar në lëndën përkatëse, NP është nota përfundimtare e lëndës për klasën përkatëse.
8. Komisioni i Vlerësimit mban procesverbal për rezultatet e nxënësve në lëndën përkatëse të arsimit bazë, të cilat dërgohen në Zyrën Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVA).
9. ZVA monitoron Komisionet e Vlerësimit dhe raporton në Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP), për procedurat e vlerësimit të nxënësve në PKAB.
10. ZVA ruan dhe dërgon në Qendrën e Shërbimeve Arsimore, Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, rezultatet e nxënësve.
11. Procedura e parashikuar në këtë udhëzim të zbatohet edhe për vlerësimin e nxënësve të pakicave kombëtare në lëndën "Gjuhë amtare", të nxënësve të seksioneve dygjuhëshe, të nxënësve të shkollave speciale si dhe të nxënësve mbetës në provimet kombëtare të arsimit bazë në vitet paraardhëse.
12. Udhëzimi nr. 3, datë 25.02.2020, "Për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë në Republikën e Shqipërisë, viti shkollor 2019-2020, sesioni i parë", shfuqizohet.
13. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia për Sigurimin e Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

MINISTRI

 Besa SHAHINI

